



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, 18 tetor 2010
Ref.nr.: AGJ 62 /10

AKTGJYKIM

Rastet Nr. 58/09, 59/09, 60/09, 64/09, 66/09, 69/09, 70/09, 72/09, 75/09, 76/09, 77/09, 78/09, 79/09, 3/10, 5/10, 13/10

Lënda e Gani Prokshit dhe 15 ish punëtorëve tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës

kundër

16 Aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare
Iliriana Islami, gjyqtare

HYRJE

1. Lënda buron nga kërkesat e parashtruara në Gjykatën Kushtetuese nga gjashtëmbëdhjetë (16) ish- punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës ndërmjet nëntorit 2009 dhe marsit 2010.
2. Lënda aktuale është e ngjashme me Lëndën KI nr. 40/09, Imer Ibrahimimi dhe 48 ish punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ku Gjykata gjeti se ka pasur shkelje të Nenit 46 (Mbrojtja e Pronës) në lidhje me Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe që po ashtu ka pasur shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) në lidhje me Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të njëjtit parashtrues. Si pasojë është marr vendim për të shpallur të pavlefshme aktgjykimet e nxjerra nga Gjykata Supreme në rastet e parashtruesve dhe ia ka kthyer këto aktgjykime Gjykatës Supreme për rigjykim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese (shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 23 qershor 2010).

Parashtruesit e kërkesës janë:

1. Gani Prokshi;
2. Ismet Ratkoceri;
3. Kadri Berisha;
4. Ali Shala;
5. Hasan Ibrahimimi;
6. Rifat Draga;
7. Avdullah Sadiku;
8. Skender Smaili;
9. Vehbi Gashi;
10. Ejup Selmani;
11. Sardi Hyseni;
12. Sylejman Mustafa;
13. Nexhat Ejupi;
14. Hazir Kadriu;
15. Xhylsime Ymeri;
16. Ibrahim Kelmendi.

3. Në këtë aktgjykim, për lehtësim referimi, Parashtruesit janë listuar si te numëruar dhe mund te referohen kolektivisht si gjashtëmbëdhjetë (16) ish punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK).

Parashtruesit sfidojnë këto Aktgjykime të Gjykatës Supreme të Kosovës të nxjerra në rastet e:

- 1) Gani Prokshi Rev.nr. 208/08, i datës 27/01/09;
- 2) Ismet Ratkocero Rev.nr. 260/08, i datës 10/02/09;
- 3) Kadri Berisha Rev.nr. 125/08, i datës 27/01/09;
- 4) Ali Shala Rev.nr. 55/09, i datës;
- 5) Hasan Ibrahimimi Rev.nr. 209/08, i datës 16/06/09;
- 6) Rifat Draga Rev.nr. 341/08, i datës 11/02/09;

- 7) Avdullah Sadiku Rev.nr. 488/08, i datës 23/02/09;
- 8) Skender Smaili Rev.nr. 176/08, i datës 11/02/09;
- 9) Vehbi Gashi Rev.nr. 225/08, i datës 11/02/09;
- 10) Ejup Selmani i Rev.nr. 514/08, i datës 11/02/09
- 11) Sardi Hyseni Rev.nr. 219/08, i datës 10/02/08;
- 12) Sylejman Mustafa Rev.nr. 459/08, i datës;
- 13) Nexhat Ejupi Rev.nr. 477/08, i datës 10/03/08;
- 14) Hazir Kadriu Rev.nr. 204/09, i datës 29/06/09;
- 15) Xhylsime Ymeri Rev.nr. 23/02/09, i datës 23/02/09;
- 16) Ibrahim Kelmendi Rev.nr. 543/08, i datës 10/03/09;

Objekti i çështjes

4. Çështja e lëndës së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve individuale të nxjerra nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës në gjashtëmbëdhjetë (16) rastet individuale të Parashtruesve kundër KEK-ut, siç është cekur më lartë.

Baza ligjore

5. Kërkesa bazohet në Nenin 113 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëlutjeshëm: Kushtetuta), Nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëlutjeshëm: Ligji) dhe Nenin 55 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëlutjeshëm: Rregullorja e Punës).

Përmbledhje e fakteve që pretendohen nga palët

6. Kërkesat e Parashtruesve cekin çështje të ngjashme me ato të përmbledhura në lëndën e "Imer Ibrahimit dhe 48 të tjerëve kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Kosovës", shih aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 23 qershor 2010. (në tekstin e mëlutjeshëm: "lënda Ibrahimit dhe të tjerët").
7. Gjatë vitit 2001 dhe 2002, secili parashtrues nënshkroi një marrëveshje për kompensim të përkohshëm të pagesës për shkaputje të kontratës së punës punëdhënësin e tyre, KEK-un. Këto marrëveshje ishin, në thelb, të njëjta.
8. Neni 1 i kësaj Marrëveshjeje përcakton se, në mbështetje të Nenit 18 të Ligjit mbi Sigurimin Pënsional dhe Invalidor të Kosovës (Gazeta Zyrtare e ish Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës nr. 26/83, 26/86 dhe 11/88) dhe konstatimit të Komisionit Invalidor të KEK-ut, përfutuesi (d.m.th. secili parashtrues) ka të drejtë për kompensim të përkohshëm për ndërprerje të marrëdhënies së punës, deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit mbi Sigurimin Pënsional dhe Invalidor të Kosovës.
9. Neni 2 i kësaj Marrëveshjeje përcaktoi se shuma mujore që duhet t'i paguhet secilit parashtrues ishte 206 marka gjermane.

10. Neni 3 përcaktoi se "pagesa sipas kësaj Marrëveshjeje përfundon në ditën e funksionimit të Fondit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës. Prej asaj dite e tutje, shfrytëzuesi mund t'i realizojë të drejtat e veta në Fondin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës, gjersa KEK-ut i ndërpritën obligimet ndaj shfrytëzuesit nga kjo Marrëveshje".
11. Më 1 nëntor 2002, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut miratoi një vendim për themelin e Fondit Pensional, në përputhje me kriteret e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/30 mbi Pensionet në Kosovës. Neni 3 i këtij vendimi thotë: "Fondi Pensional do të vazhdojnë të ekzistojë për një periudhë të pacaktuar kohore, në pajtim me kriteret dhe përgjegjësitë e përcaktuara me rregulloret mbi pensionet, të miratuara nga Bordi i Fondit Pensional dhe KEK-u, në përputhje me këtë vendim, apo derisa kushtet ligjore mbi pensionet ose rregullat mbi pensionin të miratuara nga ABPK-ja."
12. Me 25 korrik 2006, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut e anuloi vendimin në fjalë mbi themelimin e Fondit Pensional Suplementar dhe ndërpreu financimin dhe punën e Fondit Pensional Suplementar, me efekt që nga 31 korriku 2006. Sipas vendimit të 25 korrikut 2006, të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plote në përputhje me Statutin e Fondit. Për më tepër, obligimi i përgjithshëm ndaj përfituesve ishte 2,395,487 euro, depozitat bankare ishin 3,677,383 euro dhe suficiti nga përgjegjësia ishte 1,281,896 euro. Vendimi thotë se punëtorët e KEK-ut të cilët Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i pranon si persona me aftësi të kufizuara për punë do të gëzojnë të drejtat e parapara nga Ministria. Me 14 nëntor 2006, KEK-u e informoi Autoritetin Qendror Bankar se "vendimi për revokimin e Fondit Pensional të KEK-ut bazohet në vendimin e Bordit Ekzekutiv të KEK-ut dhe në vendimin e Bordit Menaxhues për Pensione ... për shkak të rrezikut financiar që kjo skemë paraqet për KEK-un në të ardhmen."
13. Sipas Parashtruesve, KEK-u ndërpreu pagesën e paraparë me marrëveshjet e verës 2006 pa asnjë njoftim. Parashtruesit pohojnë që një veprim i tillë është në kundërshtim me marrëveshjet e nënshkruara.
14. Parashtruesit gjithashtu pohojnë që dihet mirë se Fondi Pensional dhe Invalidor i Kosovës nuk është themeluar ende.
15. Në anën tjetër, KEK-u konteston pohimet e parashtruesve duke thënë se Fondi Pensional dhe Invalidor funksionon që nga 1 janar 2004.
16. Sipas KEK-ut, parashtruesit në mënyrë automatike mbulohej nga skema kombëtare invalidore në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/40 për Shpalljen e Ligjit mbi Pensionet Invalidore në Kosovë (Ligji nr 2003/23).
17. KEK-u me tutje thotë që me 31 gusht 2006 lëshoi një njoftim sipas të cilit të gjithë përfituesit e Fondit Suplementar të KEK-ut ishin njoftuar se Fondi ishte mbyllur. I njëjti njoftim konfirmonte se të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plotë në përputhje me Statutin e FPS-se, që do të thotë 60 muaj pagese ose derisa përfituesit ta arrijnë moshën 65-vjeçare, në përputhje me Vendimin e Bordit Drejtues (Menaxhues) të Fondit Pensional të 29 gushtit 2006.

18. KEK-u më tutje thotë qe parashtruesit nuk i kane kontestuar udhëzimet për pension invalidor dhe nënshkrimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës në përputhje me konkluzionet e Komisionit Invalidor.
19. Parashtruesit ngritën padi kundër KEK-ut në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Ata kërkuan që Gjykata të urdhëronte KEK-un t'ua paguante pagesat e papaguara dhe të vazhdonte t'ua paguante nga 105 euro (që është e barabarte me 206 marka gjermane) deri në përmbushjen e kushteve për ndërprerjen e pagesës.
20. Gjykata Komunale në Prishtinë miratoi paditë e parashtruesve dhe urdhëroi kompensimin monetar. Gjykata Komunale në Prishtinë gjeti (p.sh. Aktgjykimi C. Nr. 321/2006, i datës 27 korrik 2007, në rastin e parashtruesit të parë Gani Prokshi) se kushtet e parapara në Nenin 3 të Marrëveshjes nuk janë përmbushur. Neni 3 i Marrëveshjes parashikon kompensimin e pagës deri në realizimin e së drejtës të parashtruesve, "që do të thotë të drejtën për pension, gjë që nuk është e mundur për paditësin sepse ai nuk e ka arritur moshën 65 vjeçare."
21. Gjykata Komunale më tej theksoi në Aktgjykimin e sipërpërmendur se pagesa e kompensimit nuk duhet të lidhet me dispozitat e Statutit Suplementar Pensional, pasi marrëveshjet ishin nënshkruar më herët dhe Statuti nuk ka parapare se marrëveshjet e lidhura në rastet e mëhershme do të pushojnë së qeni të vlefshme. Gjykata gjithashtu sqaroi se sipas nenit 262 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, kreditori (d.m.th. një parashtrues) kishte të drejtë të kërkonte përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori (d.m.th. KEK-u) është i detyruar ta përmbushë detyrimin e tille.
22. KEK-u paraqiti ankesë ndaj aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut, duke thënë, ndër të tjera, se aktgjykimi i Gjykatës Komunale nuk ishte i drejtë sepse marrëveshjet ishin nënshkruar me parashtruesit për shkak të invaliditetit të tyre dhe se nuk mund të kërkojnë vazhdimin e marrëdhënies së punës për shkak të invaliditetit të tyre.
23. KEK-u ritheksoi se Gjykata ishte e detyruar të vendoste duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/40 për Shpalljen e Ligjit mbi Pensionet Invalidore, sipas të cilës parashtruesit kishin të drejtë për pension invalidor.
24. Gjykata e Qarkut në Prishtinë hodhi poshtë ankesat e KEK-ut dhe i gjeti parashtruesat e tyre të pabaza.
25. KEK-u ka parashtruar revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve thelbësore të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe zbatimit të gabuar të ligjit material (p.sh. Revizioni nga KEK-u me 27 janar 2009 në rastin e parashtruesit të parë Gani Prokshi). Aty përsëritej që Parashtruesit kishin të drejtë pensioni sipas Ligjit 2003/40 dhe për shkak të arsyeve humanitare KEK-u kishte vazhduar të paguante kompensimet mujore edhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit. Argumentohej që mosha e parashtruesit nuk ishte me rëndësi, por invaliditeti.
26. Gjykata Supreme miratoi revizionet e KEK-ul, rrëzoi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe refuzoi si të pabazuara kërkesë-paditë e Parashtruesve.

27. Gjykata Supreme ka theksuar që mënyra e ndërprerjes së punësimit konsiderohet e ligjshme sipas Nenit 11 .1 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 mbi Ligjin Bazë të Punës në Kosovë.
28. Gjykata Supreme gjithashtu theksoi, në rastin e Gani Prokshit (shih aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.Nr.208/2008 të 27 janarit 2009), si ne vijim: “duke marrë parasysh faktin e pakontestueshëm që pala e paditur ka përmbushur obligimin ndaj paditësit, që është pagesa e kompensimit të pagave sipas periudhës së specifikuar, që është deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit të Sigurimit Invalidor dhe Pensional, me hyrje në fuqi prej 1 janarit 2004, Gjykata ka vendosur që pala e paditur ka kryer obligimin sipas marrëveshjes. Kështu, pohimet e paditësit që pala e paditur ka për obligim të paguajë kompensimin e përkohshëm të pagave pas themelimit të Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore konsiderohen nga kjo Gjykate si të pabaza, për shkak se palët kontraktuese, deri në shfaqjen e kushtit zgjidhës – themelimin e fondit të lartpërmendur, kanë kryer obligimet e tyre kontraktuale.”
29. Më 15 maj 2009, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës lëshoi këtë njoftim për Parashtruesit: "Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, në arsyetimin e Aktgjykimit Rev. Nr 208/2008, që në Republikën e Kosovës ekziston Fondi Sigurimit Invalidor dhe Pensional që është funksional qysh prej 1 janarit 2004 nuk është i saktë dhe i pabazuar. Në dhënien e kësaj deklarate, ne konsiderojmë se fakti që Rregullorja e UNMIK-ut 2003/40 për shpalljen e Ligjit Nr. 2003/213 mbi Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i cili rregullon rastet e personave me paaftësi të përhershme, të cilët mund të gëzojnë këtë skemë në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj. Më lejoni të theksojë megjithatë që dispozitat e këtij Ligji nuk rregullojnë themelimin e Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore të vendit. Themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin mbi Pensionet e Personave Invalidore i cili është në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës." I njëjti shënim thekson që në kohën e shkrimit të atij shënimi, pensioni *inter alia* ekzistonte "pension invalidor në shumën e 45 Eurove, siç rregullohet me Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara (përfitues të këtij janë gjithë personat me aftësi të kufizuara të përhershme dhe të plotë)", si dhe "pensionet e kontribut-dhënësve prej 82 Eurosh, që rregullohen me Vendim të Qeverisë (përfitues të së cilit janë gjithë pensionistët që kane arritur moshën e pensionimit prej 65 vitesh, si dhe të cilët kane 15 vjet përvoje pune)."

Ankimet

30. Parashtruesit ankohen që të drejtat e tyre janë shkelur për shkak se KEK-u (në mënyrë të njëanshme ka anuluar Marrëveshjet e tyre, përkundër faktit se kushti i përcaktuar me Nenin 3, themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore, nuk është përmbushur. Parashtruesit theksojnë më tutje se nuk kane pasur mundësi të kundërshtojnë një shkelje të tillë në gjykatat e rregullta. Derisa Parashtruesit shprehimisht nuk ankohen për shkeljen e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), duket nga parashtresat e Parashtruesve se lënda e ankesave të tyre është e drejta pronësore (siç garantohet me Nenin 1, Protokollin 1, KEDNJ), si dhe e drejta për gjykim të drejtë (siç garantohet me Nenin 6 të KEDNJ-se).

Përmbledhje e procedurave para Gjykatës

31. Ndërmjet nëntorit 2009 dhe marsit 2010, Parashtruesit individualisht kanë dorëzuar Kërkesat në Gjykatën Kushtetuese. Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu si gjyqtar raportues dhe emëroi Kolegjin Shqyrtues të Gjykatës, të përbërë nga gjyqtar Altay Suroy, Kryetar i Kolegjit, Enver Hasani dhe Iliriana Islami.
32. Më 25 maj 2010, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Supreme, në pajtim me Nenin 26 të Ligjit, që këta parashtrues kanë atakuar aktgjykimet individuale të miratuara nga Gjykata Supreme.
33. Në të njëjtën ditë, Gjykata Kushtetuese njoftoi KEK-un, si palë e interesuar, në lidhje me parashtrimin e kërkesave të lartcekura.
34. Më 25 maj 2010, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës deklaroi që të gjitha komentet për këto raste mund të gjinden në aktgjykimet përkatëse të Gjykatës Supreme.
35. Më 02 qershor 2010, KEK-u është përgjigjur me shkrim duke thënë që të gjitha rastet e lartpërmendura janë të ngjashme me lëndën KI 40/09 dhe që prandaj kanë ofruar komentet e tyre në sesionin për lëndën KI 40/09, të mbajtur më 30 prill 2010.
36. Më 12 tetor 2010, Paneli Shqyrtues morri parasysh raportin e gjyqtarit raportues dhe bëri një rekomandim Gjykatës për pranueshmërinë e kërkesës.
37. Me 12 tetor 2010, Gjykata u mblodh në seanca të mbyllura për të shqyrtuar lëndën.

Pranueshmëria

38. Në mënyrë që të trajtohen Kërkesat e Parashtruesve, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit kanë përmbushur kriteret e përcaktuara me Kushtetutë.
39. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

dhe Nenit 47.2 të Ligjit që përcakton se:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

40. Për më shumë Gjykata duhet të shqyrtojë nëse Parashtruesit kanë parashtruar Kërkesat e tyre brenda afatit prej katër muajve, siç përcaktohet me Nenin 49 të Ligjit. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese i referohet Nenit 49 të Ligjit që përcakton se: *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera,*

afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”

41. Gjykata përkujton që në lëndën aktuale, ngjashëm si në lëndën e Imer Ibrahimit dhe ish 48 punëtorët tjetër të KEK-ut, Parashtruesit ende vuajnë nga ndërprerja e njëanshme e marrëveshjeve të tyre të nënshkruara nga KEK-u. Ata kanë ngritur të njëjtin argument ashtu si Parashtruesit në lëndën e Imer Ibrahimit dhe 48 ish punëtorët tjerë, në kuptimin se është vërtetuar që Fondi Pensional Invalidor nuk është themeluar deri më sot. Prandaj, kjo është një situatë vazhduese. Meqenëse rrethanat, në bazë të të cilave Parashtruesit kanë paraqitur ankesat e tyre, ka vazhduar atëherë afati prej katër muajve siç përcaktohet me Nenin 49 të Ligjit nuk është i zbatueshëm për këto raste.
42. Gjykata Kushtetuese është e njoftuar që një nga Parashtruesit, d.m.th. Ejup Selmani, ka qenë më i vjetër se 65 vjeç në kohën e parashtrimit të këtyre Kërkesave në këtë Gjykatë.
43. Gjykata Kushtetuese përkujton që sipas Njoftimit të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, i datës 15 maj 2009, sipas të cilit personat që kanë arritur moshën e pensionimit prej 65 vitesh dhe që kanë së paku 15 vjet përvojë pune kanë të drejtë pensioni në shumë mujore prej 82 Eurosh. Thelbi i këtij Njoftimi është konfirmuar nga përfaqësuesi i Ministrisë, në seancën publike të Gjykatës për lëndën e Imer Ibrahimit dhe 48 të tjerëve (Lënda nr. KI 40/09) të mbajtur më 30 prill 2010.
44. Rrjedhimisht, duket që parashtruesi i lartpërmendur Ejup Selmani ka të drejtë pensioni qysh prej momentit të mbushjes së moshës prej 65 vitesh.
45. Megjithatë ankesa e Ejup Selmanit, sa i përket kompensimit të papaguar për periudhën deri në atë moment, në kuptimin e situatës së vazhdueshme, mbetet e tillë dhe është pjesërisht e pranueshme.
46. Sa i përket parashtruesve tjerë, Gjykata Kushtetuese nuk gjen ndonjë arsye për mospranueshmërinë e Kërkesës.
47. Gjykata, më tutje, konsideron që është e përshtatshme të bëjë bashkimin e Kërkesave në bazë të Nenit 36 të Rregullores së Punës.

Meritat e rastit

48. Gjykata përkujton Aktgjykimin e saj të 23 qershorit 2010 në lëndën Ibrahimit dhe të tjerët, ku konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 46 të Kushtetutës (Mbrojtja e Pronës) në lidhje me Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe që po ashtu ka pasur shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) në lidhje me Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të njëjtit parashtrues. Rrjedhimisht ishte marrë vendim për të shpallur të pavlefshme aktgjykimet e nxjerra nga Gjykata Supreme në lëndët e parashtruesve dhe për t'ia kthyer këto aktgjykime Gjykatës Supreme për rigjykim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese (shih Aktgjykimin në lëndën e Imer Ibrahimit dhe të tjerëve, i datës 23 qershor 2010).

i. Sa i përket Mbrojtjes së Pronës

49. Parashtruesit ankohen se të drejtat e tyre janë shkelur për shkak se KEK-u ka anuluar Marrëveshjet e tyre në mënyrë të njëanshme, edhe pse kushti i përcaktuar me nenin 3 (pra themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore) nuk është përmbushur. Në thelb, Parashtruesit ankohen që ka pasur shkelje të drejtave të tyre pronësore.

50. Qysh në fillim, duhet rikujtuar dispozitat juridike si në vijim:

Neni 53 i Kushtetutës

"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës përcakton si në vijim:

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë shpronësimin e pronës nëse ky shpronësim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve shpronësohet.

Neni 1 i Protokollit nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton që

"Secili person fizik apo juridik ka të drejtë gëzojë posedimet e tij në mënyrë të qetë. Askush nuk mund të privohet nga posedimet e tij/saj përveç për interes publik si dhe duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara me ligj, si dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare."

Megjithatë, dispozitat paravajtëse nuk do të pengojnë në asnjë mënyrë të drejtën e Shtetit që të zbatojë ligje që i konsideron të domosdoshme për kontrollimin e shfrytëzimit të pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, apo për të siguruar pagesën e tatimeve apo kontributeve e dënimeve tjera."

51. Në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një Parashtrues mund të pretendojë shkeljen e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 vetëm deri në masën që vendimet e goditura kanë të bëjnë me "posedimet" e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite.

52. Për më shumë, "posedimet" mund të jenë ose "posedime ekzistuese" apo asete, duke përfshirë pohimet, në kuptimin e të cilave parashtuesi mund të argumentojë që ai apo ajo ka "prirje legjitime" të fitimit dhe të gëzimit efektiv të një të drejte pronësore. Në kundërshtim me këtë, shpresa e njohjes së një të drejte pronësore e cila ka qenë e pamundur të ushtrohet në mënyrë efektive nuk mund të konsiderohet "posedim" sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit Nr. 1, ashtu siç nuk mund të konsiderohet posedim as kërkesa me kusht, i cila zgjidhet si rezultat i mos-përmbushjes së kushtit (shih *Ibrahimi dhe të tjerët* dhe shih po ashtu *Prince Hans-Mam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë*, nr. 42527/98, paragrafët 82-83, GJEDNJ 2 01VIII ; dhe *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (dec.) [GC] nr. 39794/98, para. 69, GJEDNJ 2002-VII).

53. Çështja që duhet shqyrtuar në çdo rast është nëse rrethanat e rastit, të marra në tërësi, i japin Parashtuesit pronësi ndaj një interesi thelbësor të garantuar me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ (shih *Ibrahimi dhe të tjerët*).

54. Gjykata Kushtetuese vëren që në kohën e nënshkrimit të Marrëveshjeve ndërmjet Parashtuesve dhe KEK-ut, ky lloj i marrëveshjeve është rregulluar me Ligjin për Marrëdhëniet Detyimore (Ligj për Obligimet) që është shpallur në Gazetën Zyrtare të RSFJ 29/1978 dhe që është ndryshuar më 39/1985, 45/1989, 57/1989.

Neni 74(3) i Ligjit për Marrëdhëniet Detyimore përcakton si në vijim:

"Pas shkëputjes sipas kushtit zgjidhës, kontrata pushon të jetë e vlefshme pasi ai kusht të jetë i vlefshëm."

55. Thelbi i çështjes kështu është nëse kushti zgjidhës sipas të cilit janë nënshkruar Marrëveshjet është përmbushur. Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje do t'i mundësonte Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse rrethanat e kësaj Kërkese, të shqyrtuara si të tëra, i japin Parashtuesve të drejtën ndaj interesit thelbësor të mbrojtur nga Neni 1, Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së.

56. Gjykata Kushtetuese vëren se është e qartë nga dokumentet dhe është e pakontestueshme mes palëve që "kushti zgjidhës", sipas të cilit janë nënshkruar Marrëveshjet, është themelimi dhe funksionimi i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Kosovës."

57. Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese vëren që sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore do të duhej të rregulluar në bazë të ligjit për Fondin e Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore. Ky i fundit ka qenë në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës.

58. Gjykata Kushtetuese konsideron që Parashtuesit, me nënshkrimin e Marrëveshjeve me KEK-un, kanë pasur prirje legjitime që do të gëzojnë dëmshpërblim mujor në shumën prej 105 Eurosh, deri në themelimin e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor.

59. Një prirje e tillë legjitime garantohet me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, natyra e saj është konkrete, dhe jo vetëm një shpresë e thjeshtë, dhe bazohet në një

dispozitë ligjore apo akt ligjor, d.m.th. Marrëveshjen me KEK-un (shih *Ibrahimi dhe të tjerët* dhe shih po ashtu *mutatis mutandis Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.)*, nr. 39794/98, paragrafi 73, ECHR 2002-VII).

60. Kështu, Gjykata Kushtetuese konsideron që Parashtruesit kanë "pritje legjitime" që kërkesa e tyre do të trajtohet në pajtim me ligjet në fuqi, në veçanti në përputhje me dispozitat e lartpërmendura të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, si dhe të Ligjit mbi Sigurimet Pensionale dhe Invalidore në Kosovë, dhe që rrjedhimisht do të njiheshin si të tilla (shih *Ibrahimi dhe të tjerët*).
61. Megjithatë, anulimi i njëanshëm i Marrëveshjeve, para përmbushjes së kushtit zgjidhës, ka shkelur interesat materiale të Parashtrueseve që ishin të njohura sipas ligjit, si dhe të mbrojtura me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (shih *Ibrahimi dhe të tjerët*).
62. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konstaton se ka shkelje të Nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

ii. Sa i përket të së drejtës për gjykim të drejtë

63. Më tutje, parashtruesit ankohen se nuk kanë qenë gjendje të zhdëmtohen për shkeljen e të drejtave të tyre pronësore në gjykatat e rregullta.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës përcakton si në vijim:

"Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike."

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

"Në përcaktimin e të drejtave civile dhe obligimeve ... secili ka të drejtë për dëgjim ... të drejtë... nga një gjykatë..."

64. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyre e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë apeli, apo gjykatë e instancës së katërt, në kuptimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme. Në përgjithësi, "Gjykatat gjykojnë në baze të Kushtetutës dhe ligjit" (Neni 102 i Kushtetutës). Me saktësisht, roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat gjegjëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjes [GCI. nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [ECHR] 1999-1)* .
65. Në anën tjetër, "Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën" (Neni 112. 1 i Kushtetutës). Kështu, Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë prezantuar në mënyrë të duhur, si dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në atë mënyrë që Parashtruesi të ketë gjykim të drejtë (shih, mes burimeve tjera, Raporti i Komisionit

Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Parashtrësia Nr. 13071/87 miratuar me 10 korrik 1991).

66. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së obligon gjykatat që të japin arsytetime për aktgjykimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për përgjigje të hollësishme për secilin argument. Masa në të cilën kjo detyrë e ofrimit të arsytimeve mund të dallojë varësisht nga natyra e vendimit. Për më tepër, është e domosdoshme të merret parasysh, *inter alia*, shumëllojshmëria e parashtrësive që një palë mund të dorëzojë në gjykata, si edhe dallimet që ekzistojnë në Shtetet Kontraktuese në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, mendimet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimëve. Kështu, çështja nëse gjykatat kanë dështuar në përmbushjen e obligimit të parashtrimit të arsyeve, që buron nga Neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në bazë të rrethanave të rastit të caktuar (*Ibrahimi dhe të tjerët dhe, Ruiz Torija kundër Spanjës*, aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, Seria A nr. 303-A, § 29).
67. Në rastin në fjale, Parashtruesit kanë kërkuar nga gjykatat e rregullta të vendosin për mosmarrëveshjen e tyre pronësore me KEK-un. Parashtruesit iu kanë referuar shprehimisht dispozitës së Nenit 3 të Marrëveshjeve, duke theksuar se Ligji për Pensionet, që themelon Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor, ende nuk është miratuar. Ky fakt është vërtetuar nga përfaqësuesit kompetent të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
68. Megjithatë, Gjykata Supreme nuk ka ndërmarrë asnjë përpjekje për analizuar paditë e parashtrueseve nga ky këndvështrim përkundër referencës së theksuar para çdo instance tjetër gjyqësore. Në vend të kësaj, pikëpamja e Gjykatës Supreme ka qenë se është fakt i pamohueshëm që pala e pandehur (KEK) ka përmbushur obligimet e saja ndaj paditësit, që ka qenë pagesa e kompensimit të pagave sipas afatit të përcaktuar deri në themelimin dhe funksionalizimin e Fondit Pensional Invalidor të Kosovës, në fuqi nga 01 janari 2004.
69. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të vendosë se cila do të ishte mënyra më e mirë që gjykatat e rregullta të trajtojnë argumentet e Parashtrueseve, d.m.th., përmbushjen e kushtit shfuqizues të Nenit 3 të Marrëveshjeve; përmbushje që përcaktohet po ashtu me Nenin 74(3) të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore marrë parasysh së bashku me Nenin 18 të Ligjit mbi Sigurimin Pensional Invalidor të vitit 1983.
70. Megjithatë sipas mendimit të kësaj Gjykate, Gjykata Supreme duke neglizhuar vlerësimin e kësaj pike në tërësi, edhe pse ka qenë konkrete, e lidhur me çështjen dhe që është e rëndësishme, ka dështuar në obligimin e saj sipas paragrafit 1 të Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih *Ibrahimi dhe të tjerët*) dhe Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të 18 korrik 2006, në rastin *Pronina kundër Ukrainës*, Kërkesa Nr. 63566/00).
71. Sipas thënieve të lartcekura, Gjykata Kushtetuese konstaton që ka pasur shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të Nenit 113 të Kushtetutës, Nenit 20 të Ligjit dhe Neneve 55 dhe 70 të Rregullores së Punës, Gjykata Kushtetuese:

VENDOS

I. Për të bashkuar Kërkesat;

II. Për të shpallur si

a) *Të Pranueshme Kërkesën në lidhje me Parashtruesit në vijim:*

1. Gani Prokshi
2. Ismet Ratkoceri
3. Kadri Berisha
4. Ali Shala
5. Hasan Ibrahim
6. Rifat Draga
7. Avdullah Sadiku
8. Skender Smaili
9. Vehbi Gashi
10. Sardi Hyseni
11. Sylejman Mustafa
12. Nexhat Ejupi
13. Hazir Kadriu
14. Xhysime Ymeri
15. Ibrahim Kelmendi

b) *Pjesërisht të pranueshme Kërkesën në lidhje me Parashtruesin në vijim:*

16. Ejup Selmani;

III. Për të gjetur se

a) *ka pasur shkelje të Nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës* në lidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet e Parashtruesve: Gani Prokshi, Ismet Ratkoceri, Kadri Berisha, Ali Shala, Hasan Ibrahim, Rifat Draga, Avdullah Sadiku, Ali Tahiri, Skender Smaili, Vehbi Gashi, Ejup Selmani, Sardi Hyseni, Sylejman Mustafa, Nexhat Ejupi, Hazir Kadriu, Xhysime Ymeri dhe Ibrahim Kelmendi.

b) *ka pasur shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës* në lidhje me Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sa i përket Parashtruesve të njëjtë, që kanë vuajtur shkelje të Nenit 46 të Kushtetutës.

III. Për të shpallur si të pavlefshme aktgjykimet e Gjykatës Supreme në rastet e mëposhtme:

1. Gani Prokshi Rev.nr. 208/08, i datës 27.01.09;
2. Ismet Ratkocero Rev.nr. 260/08, i datës 10.02.09;
3. Kadri Berisha Rev.nr. 125/08, i datës 27.01.09;
4. Ali Shala Rev.nr. 55/09, i datës 02.02.09;
5. Hasan Ibrahim Rev.nr. 209/08, i datës 16.06.09;
6. Rifat Draga Rev.nr. 341/08, i datës 11.02.09;
7. Avdullah Sadiku Rev.nr. 488/08, i datës 23.02.09;
8. Skender Smaili Rev.nr. 176/08, i datës 11.02.09;
9. Vehbi Gashi Rev.nr. 225/08, i datës 11.02.09;
10. Ejup Selmani Rev.nr. 514/08, i datës 11.02.09;
11. Sardi Hyseni Rev.nr. 219/08, i datës 10.02.08;
12. Sylejman Mustafa Rev.nr. 459/08, i datës 10.03.09;
13. Nexhat Ejupi Rev.nr. 477/08, i datës 10.03.08;
14. Hazir Kadriu Rev.nr. 204/09, i datës 29.06.09;
15. Xhylsime Ymeri Rev.nr. 23/02/09, i datës 23.02.09;
16. Ibrahim Kelmendi Rev nr: 543/08, i datës 10.03.09.

IV. Këto aktgjykime i kthehen Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.


V. Mbetet seriozisht e përkushtuar ndaj rastit, në pritje të zbatimit të këtij Aktgjykimi.

Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë në ditën e dorëzimit tek palët.

Prishtinë, 18 tetor 2010

Gjyqtari Raportues

Mr.Sc. Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani